



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:909523
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06346997

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L, L, E. dhe S. L, të gjithë nga fshati G., Komuna Ferizaj, të cilët i përfaqëson av. Dardan Hakiu nga Ferizaj, kundër të paditurve R.M, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. Avni Ibrahimimi nga Ferizaj, N.K, N.K dhe K.H nga fshati G..-Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson av. Rafiz Shehu nga Ferizaj, me objekt kontesti anulim i kontratës së shitblerjes së pronës së paluajtshme dhe vërtetimi i të drejtës së parablerjes, vlera e kontestit e pacaktuar, jashtë seance me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia me shenjën 2023:260602, e paditësve L, L, E. dhe S. L, të gjithë nga fshati G., Komuna Ferizaj, kundër të paditurve R.M, N.K, N.K dhe K.H, me objekt kontesti anulim i kontratës së shitblerjes së pronës së paluajtshme dhe vërtetimi i të drejtës së parablerjes, vlera e kontestit e pacaktuar.

II. DETYROHEN paditësit L, L, E. dhe S. L që solidarisht të paditurit K.H të ja kompensojnë shpenzimet procedurale në lartësinë prej 712,40€ (shtatëqind e dymbëdhjetë euro e katërdhjetë cent).

III. HEDHET si jolëndore kërkesa e paditësit Lirim Lami përmes të autorizuarit të tij av. Dardan Hakiu nga Ferizaj që gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin propozuesit Lirim Lami ju kthehet depozita prej shumës 9000€.

A r s y e t i m

Paditësit të cilët i përfaqëson av. Dardan Hakiu nga Ferizaj kanë ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 09.07.2013, kundër të paditurve, për çështjen objekt kontesti anulim i kontratës

së shitblerjes së pronës së paluajtshme dhe vërtetimi i të drejtës së parablerjes, vlera e kontestit e pacaktuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.3450/18 të dt. 26.09.2022 e ka aprovuar si e bazuar ankesën e të autorizuarit të padisëve L.L, L.L, E.L dhe S.L të gjithë nga fsh. G.-K.Ferizaj, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.446/16, të dt. 12.06.2018 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në procedurën e rivendosjes i ka ftuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse në seancën gjyqësore të dt. 15.10.2024.

Përfaqësuesi i paditësve av. Dardan Hakiu nga Ferizaj në seancën e datës 15.10.2024 deklaroi se pas shpjegimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe aktvendimeve të mëparshme palët janë bindur se ne rastin konkret mungon baza ligjore e fitimit të pronësisë nga e drejta e parablerjes dhe të njëjtit propozojnë që të konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje juridike kontestuese dhe gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin propozuesit Lirim Lami ju kthehet depozita prej shumës 9000€.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit R.M, i caktuar me aktvendim të kësaj gjykate av. Avni Ibrahimimi nga Ferizaj dhe përfaqësuesi me autorizim i të paditurit K.H, av.Rafiz Shehu gjatë seancës të datës 15.10.2024 japin pëlqimin për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridike kontestuese nga ana e paditësve. Përfaqësuesi me autorizim i të paditurit K.H, av.Rafiz Shehu i ka kërkuar shpenzimet procedurale sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të dt. 12.06.2018 dispozitivi nr. 2, shuma 712.4€.

Me aktvendimin e gjykatës të marrë në shqyrtimin e dt. 15.10.2024, ftohet avokat Dardan Hakiu nga Ferizaj që ne afat prej 5 diteve nga dita e sotme të ja dorëzoj gjykatës autorizimin për përfaqësimin e paditësve Ejup dhe Selam Lami ose miratimin për deklaratën e tërheqjes së padisë nga ana e tij në këtë çështje juridiko civile.

Duke vepruar në bazë të udhëzimit të gjykatës, Avokat Dardan Hakiu nga Ferizaj me parashtrësën e dt. 21.10.2024 ja ka dorëzuar gjykatës autorizimet për përfaqësimin e paditësve S.. dhe E.L, të cilët deklarojnë se avokati ka të drejtën në emër tim të tërhiqet nga padia dhe deklarimi i dt. 15.10.2024 në seancë nga avokati që unë tërhiqem nga padia është deklarimi i imi dhe qëndroj pranë deklaramit për tërheqje nga padia dhe kërkesëpafia.

Gjykata me aplikimin e dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1, pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi, me të cilin detyrohen paditësit L, L, E. dhe S. L që solidarisht të paditurit K.H të ja kompensojnë shpenzimet procedurale në lartësinë prej 712,40€ (shtatëqind e dymbëdhjetë euro e katërdhjetë cent), edhe atë për 2 seanca të mbajtura shumë prej 270.4€, për 5 seanca të shtyra shumë prej 338€ dhe për përgjigje në padi shumë prej 104€. Në përputhje me nenin 456.1 të LPK parashihet që: “Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit.”.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm CN.nr.391/13 të dt. 09.01.2014, aprovohet propozimi i paditësve L., I., E. dhe S.L. dhe caktohet masa e sigurimit ashtu që të paditurit K.H i ndalohet të bëjë tjetërsimin, ngarkimin me hipotekë apo me ndonjë të drejtë tjetër sendore apo të ndryshojë gjendjen ekzistuese të paluajtshmërisë – njësisë kadastrale P-.... në v.q “Xh.” në $\frac{3}{4}$ e sip. së përgjithshme prej ... m² ZK G.... Në këtë drejtim, Gjykata e ka shqyrtuar kërkesën e të autorizuarit të paditësve av. Dardan Haku që gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin propozuesit L.L ju kthehet depozita prej shumë 9000€, por sipas vlerësimit të gjykatës kjo kërkesë duhet të hudhet si jolëndore për shkak se depozita e kërkuar në shumë 9.000€ nuk është pjesë përbërëse e shkresave të kësaj lënde, me arsyetimin se çështja lidhur me masën e sigurimit ka numër tjetër veprues përkatësisht numrin CN.nr.391/13, e cila vërtetohet me leximin e aktvendimit CN.nr.391/13 të dt. 09.01.2014. Lidhur me këtë as me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.446/16 të dt. 12.06.2018, nuk është vendosur për kthimin e depozitës, gjë që të qon në përfundimin e drejtë dhe të ligjshëm se kërkesa e paditësit Lirim Lami për kthimin e depozitës në këtë çështje duhet të hedhet si jolëndore.

Nga të gjitha të lartëcekurat, e në bazë të nenit 142, 261, 387.1, pika c), 456.1 dhe 463.1 të LPK, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm

Datë 24.10.2024

Gj y q t a r i,

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër pikës I. të këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK ndërsa kundër pikës II. dhe III. të këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit e Kosovës, nëpërmjet të kësaj Gjykate.